

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rama për Gjykatën Kushtetuese: Detyra jote është të mos na lejosh ta ngremë dorën gabim, jo të na dik tosh si ta ngremë!
ADRESA	https://dosja.al/politike/rama-per-gjykatën-kushtetuese-detyra-jote-eshte-te-mos-na-lejo-sh-ta-ngr-i514769
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 06:38:00 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 06:24:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a036400013ed9508e4f9583483dcc59a66d2e61b27d6026e59604d58877199a9
TEKSTI	94b2af6e9531842839e954c88ad318910e77d11abeb491352f2c4097300667e9
PAMJA	c5ef48e5c4d0db707a6adb54d578e1df045b23a35bc4cce000af361405fcbc17

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	34f1b88340661f87d714ae7330c1d21ae133cc323aa7ebc4c332cfd89750c99f
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	3cbdf23231ddbe1301737130b50cb215bb8d138f7bee92a7c7c6c6c8c9c45afe
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/34f1b88340661f87d714ae7330c1d21ae133cc323aa7ebc4c332cfd89750c99f>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

12 ORE ME PARE

110 ditë qëndresë/ Pas protestës para Kuvendit qytetarët mbledhen sërish në Bulevard: Arrestoni Ramën!

17 ORE ME PARE

Vendimi i Hagës nxiti protesta dhe reagime në Kosovë/ PDK mbledh Kryesinë, familjarët: Gjykatë kriminale, presim pafajësi në Apel

22 ORE ME PARE

Pagat e magistratëve, PS propozon rritje sa 2% e pagës së Presidentit! Rama shkon në Kuvend. Bardhi: Puç kushtetues

22 ORE ME PARE

"Nuk na përfaqësoni"/ Qytetarët protestojnë pranë Kuvendit, përplasen me policinë, shoqërohen disa prej tyre

Politike

Rama për Gjykatën Kushtetuese: Detyra jote është të mos na lejosh ta ngremë dorën gabim, jo të na diktosh si ta ngremë!

Gjatë fjalës së tij në Kuvend, Rama u shpreh se veprimet e hetuesve, prokurorëve dhe gjyqtarëve ndaj zyrtarëve të Financave dhe Thesarit tregojnë nevojën për të përcaktuar qartë kufijtë mes pushteteve.



18 Shtator 2026, 08:24
Nga E.d



Edi Rama

TIRANA- Kryeministri Edi Rama ka deklaruar se respektimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nuk do të thotë që ajo mund t'i diktojë Kuvendit se si të votojë. Gjatë fjalës së tij në Kuvend, Rama u shpreh se veprimet e hetuesve, prokurorëve dhe gjyqtarëve ndaj zyrtarëve të Financave dhe Thesarit tregojnë nevojën për të përcaktuar qartë kufijtë mes pushteteve.

Duke folur për përplasjet lidhur me pagat e magistratëve, Rama tha se Gjykata Kushtetuese duhet të përcaktojë kufijtë kushtetues të veprimit të Kuvendit, por vendimmarrja politike mbetet përgjegjësi e ligjvënësve. Më tej, ai shtoi se Prokuroria e Posaçme nuk ka kërkuar rritje pagash, duke shtuar se vendi ka hyrë në një fazë të re zhvillimi.

Në fund, ai tha se Kuvendi ka përgjegjësi që ta forcojë dinamikën e ndarjes së pushteteve, por ka edhe përgjegjësinë që të tregoj se ku mbaron njëri dhe ku fillon tjetri. Lideri i qeverisë, theksoi se Kushtetuta flet për tre pushtete të pavarura, ku ata janë reciprokisht të pavarura dhe të ndërthurura.

Edi Rama: Ne nuk vëmë në diskutim që do të respektojmë mendimin e Gjykatës Kushtetuese, ashtu siç ne e kuptojmë dhe Gjykata Kushtetuese këtë diskrecion ia lë Kuvendit. Madje, Gjykata Kushtetuese përcakton edhe kornizën e mundësive që janë në dispozicion në këtë pikë. Por unë mendoj që Kuvendi i tëri do t'i japë Gjykatës një mesazh shumë të qartë: me këtë rast, detyra juaj është që të mos lejoni që ne ta ngremë dorën gabim, por detyra jonë është t'ju themi që ju nuk na e thoni dot kurrë se si ne ta ngremë dorën. Nëse këto të dyja ngatërrohen, ne kemi një problem shumë të madh, i cili nesër mund të bëhet shumë më i madh. Dhe këtu nuk ka absolutisht asnjë lloj sfide, asnjë lloj lufte të asnjë natyre me sistemin e drejtësisë, asnjë lloj presioni, absolutisht asgjë të tillë.

editoriale

Irena Beqiraj

Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika

Plaçkaxhiu

Në vëmendje

AKTUALITET 18 SHTATOR 2026, 07:21

Gati gjysma e shqiptarëve kanë vështirësi të mbyllin muajin, e dyta në Europë

BOTA 18 SHTATOR 2026, 07:15

Hetimet për nënshkrimet e partisë/ Parlamenti European i heq imunitetin eurodeputetes greke Afroditi Latinopoulou

Se po ju kujtoj edhe diçka tjetër, nëse i shkojmë fillit të logjikës së atyre që e paraqitën këtë si një tentativë për presion, Prokuroria e Posaçme nuk ka kërkuar rritje pagash. SPAK nuk ka kërkuar rritje pagash, as ka çuar listëpagesën përveçse sipas formulës së vjetër. Kështu që kjo bie si logjikë, edhe sikur po e marr për një moment të mirëqenë, që s'është. Këtu është një çështje shtetbërjeje europiane.

Ne kemi hyrë në një fazë të re. Ne qartësisht e kemi një pushtet të ri të pavarur në këtë qytet dhe pikërisht pse është një pushtet i ri i pavarur, po shohim gjëra që janë të paimagjinueshme në një demokraci të konsoliduar: me hetues që shkojnë në Ministrinë e Financave, me prokurorë që shkojnë në dyert e Thesarit, me gjykatës që kërcënojnë zyrtarët e Thesarit. Pra, jemi në kushtet e një trupe e cila po shijon pavarësinë e vet. Këtë duam ne? Këtë duam? Këtë doni ju? Unë nuk besoj se këtë duam ne.

Unë besoj që ne kemi përgjegjësi që ta forcojmë këtë dinamikë të ndarjes së pushteteve, por kemi njëkohësisht përgjegjësi që të tregojmë se ku mbaron njëri dhe ku fillon tjetri pushtet. Kushtetuta nuk flet për dy autoritete dhe një pushtet të pavarur. Kushtetuta flet për tre pushtete të pavarura. Janë reciprokisht të pavarura dhe reciprokisht të ndërthurura./Dosja.al

edi rama

Sondazh

Poll

Politike

18 Shtator 2026, 08:16

"SPAK dhe GJKKO janë dy suksese të reformës në drejtësi"/ Rama: KLP dhe KLGJ kanë falimentuar

Edi Rama TIRANA- Kryeministri Edi Rama ka deklaruar se SPAK dhe GJKKO janë dy suksese të reformës në drejtësi, pava...

"Kush është ai pushtet që i vendos afat Kuvendit?"/ Rama për pagat e magjistratëve: Askush nuk mund t'i diktojë Kuvendit kur të mblidhet

Politike

18 Shtator 2026, 08:07

Rama për pagat e magjistratëve: Lëvizjet e koordinuara mes shoqatave dhe gjyqësorit dëmtojnë Republikën e Shqipërisë

Politike

18 Shtator 2026, 07:17

AKTUALITET 18 SHTATOR 2026, 07:12

"Taksë e fshehtë" mbi naftën për rezervën e sigurisë, do të rritet çmimi, e pranon dhe qeveria

më të klikuarat

Regjistruan 1143 hektarë me dokumente false/ Arrestohen dy ish-drejtorë dhe juristi i ASHK Fier, në pranga edhe një punonjës (EMRAT)

Falsifikime dhe shpërdorim detyre/ Pezullohen dy zyrtarë në Tiranë, shpallet në kërkim shqiptaro-izraeliti me tre identitete

Shkatërrohet organizata shqiptare që frymëzoi serialin e famshëm 'Marbella'/ Kapen 2.7 ton kokainë, sekuestrohen dy armë zjarri dhe 29 mjete luksoze, 15 persona të arrestuar (VIDEO)

Kontrolle në burgjet e Peqinit dhe Fierit/ Kapen celularë, arrestohet një i burgosur dhe procedohen 9 persona

insights

Auron Janku

Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Ola Xama

Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari

Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka

Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?

Moti

Powered by tomorrow.

Kuvendi miraton me 84 vota projektligjin për pagat e magjistratëve/ Rama voton pro, Berisha mungon

Politike

18 Shtator 2026, 07:51

"Çështja Becchetti"/ Rama: E ka fituar arbitrazhin por do marrë zero lekë nga shteti shqiptar

Politike

17 Shtator 2026, 23:45

Politike

17 Shtator 2026, 22:40

"Një prokuror rrethi dërgoi OPGJ-në në degën e Thesarit"/ Malaj: U tha punonjësve ekzekutoni pagesat, ose do ju arrestojmë

Petrit Malaj TIRANË- Ministri i Financave, Petrit Malaj, ka deklaruar në Kuvend se një prokuror rrethi ka dërguar oficerin e...

Protesta kundër vendimit të Speciales/ Djali i Thaçit dhe Veselit i bashkohen qytetarëve: Populli është me UÇK-në

Politike

17 Shtator 2026, 22:37

"Nisma të tilla kërkojnë mendimin e Këshillit të Ministrave"/ Manja: Kjo që ju bëni për pagat e gjyqtarëve, është politikë

Politike

17 Shtator 2026, 22:20

"Është një debat aspak fisnik"/

Bylykbashi për pagat e magjistratëve: Këta kanë ardhur me projekt gjigant për të grabitur shqiptarët, janë interesa miliarda

Politike

17 Shtator 2026, 22:08

"Kosova duhet të vendosi vetë për të ardhmen e saj" / Dënimi ndaj ish-krerëve të UÇK-së, Grenell: S'ka nevojë për një gjykatë në Holandë që të marrë vendime

Politike

17 Shtator 2026, 21:59

MË SHUMË



Protesta e 110-të kundër qeverisë/ Qytetarët rrethojnë komisariatit nr.1, thirrje: Lironi çunat

Shiko video te tjera



KTHEHU NE KRYE



Dosja.al është një iniciativë gazetare e rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444
Email:



KONTAKT PRIVACY POLICY COOKIES

MEMBERSHIP TIGA Mediasdesk

AKTUALITET

POLITIKE

EKONOMI

BOTA

SPORT

ART&ARGËTIM

INSIGHTS

EDITORIAL

Drejtore: Enton Abilekaj

Kryeredaktor: Izmir Akulli

Gazetarë:

Esmeralda Doçi

Emanuela Dida

Elisa Karaj

Dorotea Simoni

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.